



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 3152/13 Prot.

Tiranë, më 15.05 2015

URDHËR

Nr. 187, datë 15.05 2015

PËR

"AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, QË PËRFUNDON ME DIPLOMË TË DYFISHTË NË DOKTORATË, NË "ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM URBAN" TË UNIVERSITETIT POLIS NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E STUDIMEVE TË FERRARË-S, ITALI"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Arkitekturë dhe Planifikim Urban" të Universitetit Polis në bashkëpunim me Universitetin e Studimeve të Ferrarë-s, Itali, që realizohet me 60 kredite/në vitin e parë, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike, që zhvillohet në gjuhën angleze, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e dyfishtë në Doktoratë në "Arkitekturë dhe Planifikim Urban".
2. Ky program studimi akreditohet në bazë të Vendimit nr. 36, datë 05.05.2015, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti Polis.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare"

LINDITA NIROLIA

MINISTËR

